



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE**

MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

DEPARTAMENTI I TREGTISË

SEKTORËT POTENCIAL EKSPORTUES

Përgatitur nga:

Merita Fetahu – Analiste e tregtisë

TETOR 2019

***T*ENDENCAT E ZHVILLIMIT TË SEKTORËVE POTENCIAL EKSPORTUES**

Ekonomia e vendit ka vazhduar të ballafaqohet me disekuilibër kundrejt sektorit të jashtëm. Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme ka ndikuar në rritjen e mëtejme të importit. Andaj, rritja e konsumit dhe investimeve ka ndikuar në rritjen e importit, gjë që është kuptuar në rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse.

Shoqëria kosovare ende ballafaqohet me një varg problemesh dhe vështirësish për t'iu bashkangjitur rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar veçmas në sferën ekonomike.

Në sektorin e mallrave bilanci i tregtisë së jashtme është mjaft negativ i përcjellorë nga viti në vite. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që NVM-të e Kosovës nuk janë konkurrense në nivel ndërkombëtar, eksportuese të dobëta dhe si pasojë e kësaj pengojnë kontributin e mëtutjeshëm të NVM-ve në BPV, krijim të vendeve të punës dhe rritje ekonomike. Për dallim nga kjo, sektori i shërbimeve ka funksionuar mjaft mirë.

Trendët e tregtisë së jashtme na japin një pasqyrë të qartë mbi gjendjen ekonomike e veçmas për gjendjen e sektorëve prodhues. Kështu në një mënyrë shkallën e zhvillimit ekonomik e shprehin edhe treguesit e tregtisë së jashtme përkatësisht bilancin tregtar. Pengesat në zhvillimin e sektorit të jashtëm si: kolapsi i sektorit privat pas luftës, procesi i privatizimit, investimet e huaja direkte, performanca e institucioneve dhe kompanive të Kosovës, korniza ligjore dhe çështjet tjera, janë shkaqet që kanë ndikuar dhe ndikojnë në gjendjen e pavolueshme të sektorit të eksporteve. Duke marrë për bazë se sektori i tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, andaj politika tregtare është një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Përkundrazi eksportet në BPV është mjaft e vogël dhe jo shumë premtuese edhe për një periudhë të gjatë kohore. Trendët e saj pothuajse janë të pandryshuar, pjesëmarrja e saj gjatë viteve të fundit sillet rreth 5.5% - 5.8%.

Megjithatë, vendi ka potencial të konsiderueshëm në industrinë e bujqësisë dhe minierave.

Rritja e vlerës së eksportit të mallrave kosovare kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit.


Po ashtu rritje të vlerës kanë shënuar edhe kategoritë e mallrave të përfshirë në sektorin e industrisë së përpunimit ushqimor – pijeve, produkteve bimë të sektorit të plastikës, lëkura, veshmbathje etj.

Prodhimi bujqësor është parë si faktor thelbësor për interesin kombëtar në shumë vende në zhvillim dhe se si një prodhim bujqësor ka qenë si rezultat direkt dhe indirekt dhe të mbrojtura nëpërmjet tarifave të larta, kuotat dhe kufizimet e tjera të importit. Subvencionet dhe kufizimet e importit janë zvogëluar në vitet e fundit nën regjimin e WTO-s, por të gjitha ekonomitë e mëdha vazhdojnë të subvencionojnë prodhimin bujqësor dhe të imponojnë tarifën e lartë dhe kufizimet e tjera të importit për të mbrojtur prodhimin vendor.

Megjithatë, prodhimi bujqësor është kritik për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Në Kosovë, importet e mallrave bujqësore tejkalojnë eksportet e cila rezulton në deficitin e lartë tregtar.

Në vitet e fundit për te gjithë kategoritë e mallrave, deficitin tregtar tejkalon 2.5 miliardë euro. Kështu, në vitin 2018, eksportet mbuluan 11% të importeve, një rënie prej rreth 1.5% nga viti 2017. Eksporti i mallrave arriti vlerën në 367 milionë euro, një rënie prej 2.8% nga viti 2017. Ndërsa, importet arritën në 3.3 miliardë euro, një rritje prej 9.6% nga 2017. Grafiku i mëposhtëm tregon zhvillimin e bilancit tregtar të Kosovës nga viti 2008 -2018.

Fig1. Bilanci tregtar 2008 – 2018 (mil euro)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Rritja e vlerës së eksporteve kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit.

Po ashtu rritje të vlerës kanë shënuar edhe kategoritë e mallrave të përfshirë në sektorin e industrisë së përpunimit ushqimor – pijeve, produkteve bimore të sektorit të plastikës, lëkura, veshmbathje etj.

Nga raporti i vëllimit tregtar në BPV, e veçmas një vështrim më nga afër i zhvillimeve të importit dhe të eksportit do të kemi një pasqyrë të qartë se në ç ‘mase mund të themi që tregtia ka ndikuar pozitivisht në ritmet e rritjes ekonomike. Që tregtia ka ndikuar në një rialokim pozitiv të burimeve, që tregtia duhet konsideruar si një nga shtyllat e rritjes së efikasitetit të burimeve prodhuese në përgjithësi. Natyrisht, kjo pamje e paraqitur në Fig.nr1 dhe Fig nr.2 nuk është shumë optimiste. Prezenca e mallrave kosovare në tregjet e jashtme tregon se niveli i vëllimit të eksportit edhe sikur gjatë gjithë periudhave të mëparshme kanë qenë negativ ose për më tepër në rritje vazhdueshme të deficitit tregtar ngjashëm me vitet paraprake.

Fig2. Treguesit e performancës së tregtisë së jashtme të Kosovës (%)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Rezultatet e analizës së ecurisë dhe vëllimit të tregtisë së jashtme referuar sektorëve, janë tregues kyç ku nxjerrin në pah gjendje faktike të zhvillimit ekonomik dhe integritetit tregtarë në njërin anë si dhe identifikimin dhe dinamikën e sektorëve potencial, strukturën eksportive përkatësisht gjendje e prodhuesve vendor për sektorë të ndryshëm në periudhat e ndryshëm kohore në anën tjetër. Fig.nr1 dhe Fig.nr2 janë mjaft të dobishme kur diskutohen skenarët potencial të rritjes ekonomike si faktorët kyç në krijimin e qëndrueshmërisë së saj.

Andaj nga trendët e tregtisë së jashtme dhe analiza e tyre u identifikuan sektorët me më ndikim në ekonominë vendore të cilët janë mjaftë premtues në përmirësimin e bilancit tregtarë si dhe në zhvillimin ekonomik në tërësi në nivel vendi.

- **Metalet bazë dhe artikujt prej tyre** - Përbërja sektoriale e tregtisë mbetet kryesisht e ngjashme, krahasuar me vitet e mëparshme. Eksportet në Kosovë nuk janë të larmishme. Struktura e eksporteve në përgjithësi për vite të tëra ka qenë pothuajse e njëjtë vazhduar edhe në vitin 2018. Metalet baze të papërpunuar dhe produktet minerale paraqiten si zërat kryesor për eksportet kosovare, ato kanë mbuluar 48% të eksporteve në nivelin e përgjithshëm, (2018). Kështu, në rritjen e vazhdueshme të eksporteve të përgjithshme ka ndikuar rritja e eksporteve për metale ku tabela mëposhtme jep një pasqyrë fare të qartë mbi ecurinë e kësaj kategorie mallrash e cila në masë të jashtëzakonshme është e varur nga gjendja e tregjeve ndërkombëtare d.th nga niveli i çmimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e bilancit tregtar të Kosovës.

Fig3. Metalet baze dhe artikujt e saj – eksporti (mil €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Ende kemi një kufizim të mallrave të prodhuara nga kompanitë kosovare, munde të konsiderohet se gama e mallrave është shumë e limituar, jo e shpërndarë dhe është mjaft homogjene. Problemi më i theksuar për kufizimin eksporteve për produkte finale qëndron në: Infrastruktura e dobët e cilësisë -mungesa e standardeve sanitare dhe fito-sanitare, mungesa e laboratorëve për testim dhe certifikimit të produktit, mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe investimeve kapitale dhe kufizimet e tjera në mjedisin e bizneseve, kompanive që mirën me prodhim.

Andaj, ende vërehet dominimi i nikelit, i cili prin në krye të listës si produkt me i eksportuar, duke mbuluar 10% të totalit të eksporteve ne 2018, pasuar nga mbetjet e çelikut, energjia elektrike, xeherore dhe koncentrate plumb, tuba tubacione dhe profile të tjera prej gize dhe çeliku, ujërat - përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar etj.


Tab1.Top 5 sektorët me të mëdhenj eksportues, 2008 – 2018 (mil€)

Sections (HS)/ Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	124,774	88,363	186,131	193,143	145,813	143,911	167,387	157,732	111,175	135,410	125,232
Produkte minerale	18,669	24,952	38,944	40,575	36,485	48,352	44,704	41,615	63,885	72,697	51,275
Plastikë, gome dhe artikuj prej tyre	6,476	6,357	8,153	12,429	14,003	18,205	16,268	23,470	28,872	35,630	44,796
Ushqime të përg. pije dhe duhan	10,597	9,356	11,505	12,937	16,051	19,337	20,489	25,437	27,650	36,883	38,726
Vegetable products	8,986	9,484	12,217	12,766	14,359	15,408	18,541	15,538	16,824	23,431	23,826

Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Duket ju referuar tabelës se mësipërme nënkuptohet se sektori i mallrave prej plastike dhe atyre bujqësore do të ketë një perspektiv dhe është mjaftë premtuese ne të ardhmen. Vlera totale e eksporteve bujqësore në vitin 2018 ka arritur në EUR 63.6 milion. Kjo paraqet rritje prej 89 për qind krahasuar me vitin 2014, ndaj vitit 2015 me 52% rritje etj. Ndërsa, sektori i plastikës ka arritur vlerën eksportuese ne 44.7mil Euro ne vitin 2018. Por nëse bëjmë krahasimin me atë të vitit 2014 shohim se ka një rritje të shumëfishtë mbi 175%. Rritja më domethënëse për të dy sektorët u shënuar në dy vjetët e fundit. Për vlerat e detajuara të eksportit, shih Tab1 dhe Fig 4 top 5 sektorët eksportues %.

Fig4: Top 5 sektorët me të mëdhenj eksportues 2018 (%)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- **Produktet bujqësore** - prodhimi bujqësor është parë si faktor thelbësor për interesin kombëtar në shumë vende në zhvillim dhe se si një prodhim bujqësor ka qenë si rezultat direkt apo indirekt të mbrojtura nëpërmjet tarifave të larta, kuotat dhe kufizimet e tjera të importit. Subvencionet dhe kufizimet e importit janë zvogëluar në vitet e fundit nën regjimin e WTO-s, por të gjitha ekonomitë e mëdha vazhdojnë të, subvencionojnë prodhimin bujqësor dhe të imponojë tarifatat e larta dhe kufizimet e tjera të importit për të mbrojtur prodhimin vendor.

Në Kosovë, mallrat bujqësore të importuar shumëfish e tejkalojnë atë të eksportuar e cila rezulton më deficitin e lartë tregtar. Eksportet që i përkasin mallrave bujqësore dhe atyre industriale ushqimore janë pijet, pijet e gazuara, alkoolet, kafeja, zarzavatet e ndryshëm (perimet), etj. Pavarësisht rritjes së vëllimit të eksportit për produktet bujqësore, prapëse prapë kemi një deficit të lartë tregtar për këto kategori produktesh. Andaj, prodhimi bujqësor është dhe do të mbetet kritik për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Në vitin 2018 janë eksportuar 63.6 milion euro produktet bujqësore apo 17.3% e vlerës së eksporteve të përgjithshme kurse janë importuar 704.5 milion euro ose 21% e importeve totale në Kosovë një bilanc tejet negativ (– 640.9 milion euro), çka d.th se tregu vendor edhe për produkte bujqësore është i varur nga importi dhe për këtë eksportojmë miliona euro në vit. Kjo reflekton në ekonominë e Kosovës, duke ndikuar negativisht në bujqësi, në industrinë e përpunimit të ushqimit, në krijimin e industrive të reja dhe në sektorët e tjerë prodhues. Mesatarisht, 76% - 80% eksporteve të përgjithshme kosovare me përmbajtje të produkteve bujqësore dhe të industrisë përpunuese ushqimore kanë qenë të orientuara në tregjet e rajonit, përkatësisht në vendet anëtare të CEFTA-s. Por përqindja e produkteve bujqësore të eksportuar në vendet e rajonit në vitet e fundit ka rënë në 60% – 65 %, çka d.th se produktet bujqësore kanë filluar të orientohen edhe në tregjet e BE-s. Do të thotë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-s, eksportet e produkteve bujqësore u dyfishuan. Po ashtu importet u shumëfishuan, që tregon se ka disbalans të madh tregtar për Kosovën. Megjithatë, mund të konsiderohet se sasia e eksportuar është ende relativisht e vogël dhe ato janë në gjendje të sigurojnë vetëm një pjesë të vogël të kërkesës jashtë tregut vendor për produkte të tilla. Për pasojë edhe kërkesa për konsum vendor për produkte bujqësore të përpunuara dhe të papërpunuara plotësohet kryesisht nga importet.

Fig5. *Eksporti i produkteve bujqësore dhe industriale(mil €)*



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Analiza e të dhënave tregtare për katër krerët kryesor të produkteve bujqësore tregon se në vitin 2018 Kosova kryesisht ka eksportuar produkte nga Seksioni IV: Artikujt ushqimor, pijet dhe duhani (38.7 milion) dhe Seksioni II: Produktet vegjetale (23.8 milion euro). Produktet e këtyre dy seksioneve përbënin 98.3% të të gjitha eksporteve të produkteve bujqësore. Krahësuar me vitin 2014 të dy seksionet shënuan rritje; Pjesa IV, në veçanti u rrit ndjeshëm për 89%, ndërsa Pjesa II - produktet vegjetale shënoi rritje për 29%.

Pjesëmarrja e Kreut I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore; dhe Kreut III: vajra dhe dhjamërat prej kafshëve në eksportet totale të produkteve bujqësore ishin të papërfillshme – të dyja arrijnë 1.06 milion euro apo më pak se 2 për qind në eksportin total të produkteve bujqësore (në vitin 2018). Për më shumë informata mbi eksportet e produkteve bujqësore, shih Tab2. Eksporti i produkteve bujqësore 2008-2018.

Sektori i industrisë së ushqimit dhe pijeve si dhe produktet bimore mbeten një potencial i konsiderueshëm për të rritur vlerën e prodhimit në këtë kontekst edhe nivelin e eksportit të cilët kanë shënuar rritje për vite të tëra. Pavarësisht nivelit të rritjes jo shumë të larta e shprehur në vlera, ato mbeten si burime të mëdha për prodhim si dhe potencial të rritjes dhe qëndrueshmërisë ekonomike.

Pra, nga krahasimi i treguesve real të tregtisë, rezulton se sektori i industrisë së ushqimit dhe pijeve edhe ai bimor ka tendencë rritje dhe kjo rritje premtan një trend pozitiv që do të ndihmojë në përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e përparësive konkurruese.

Mbulojnë 13% të eksporteve të përgjithshme kosovare (2015), 14.4% (2016), 16% në 2017 dhe 17% (2018).


Tab2. Eksporti i produkteve bujqësore 2008 – 2018 (mil €)

Seksionet sipas (HS)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë	1,158	1,077	928	437	339	156	309	666	774	846	724

kafshe												
Produkte bimore	8,986	9,484	12,217	12,766	14,359	15,408	18,541	15,538	16,824	23,431	23,826	
Yndyrëra	23	76	100	45	59	46	19	41		179	343	
Ushqime të përg. pije dhe duhan	10,597	9,356	11,505	12,937	16,051	19,337	20,489	25,437	27,650	36,883	38,726	
Total	20,763	19,993	24,750	26,185	30,808	34,947	39,358	41,682	45,248	61,339	63,619	


Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig6. Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore, 2008 - 2018 (mil €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig7: Industria e ushqimit dhe pijeve - Eksporti (mil €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit


Ne Tab3. janë të paraqitura eksportet më të mëdha për kategoritë e mallrave që hyjnë në sektorin e industrisë së produkteve ushqimore dhe pijeve. Mirëpo, pjesa më e madhe e eksporteve në këtë sektorë nga viti në vite janë për nënë sektorin Ujërat, ujërat minerale dhe të gazuara (në vitin 2016 kanë mbuluar 33%, 30% në 2017 dhe 33% në 2018), të eksporteve të përgjithshme në nivel të sektorit të industrisë së ushqimit dhe pijeve. Po ashtu vlen të ceket se në këtë sektor të industrisë së ushqimit dhe pijeve nën sektorët si: prodhimi i verërave, birra, çokolatë dhe produktet e tjera dhe Torte,kek,biskotat dhe produkte nga furrtari paraqesin një trend mjaft pozitiv dhe premtues në rritjen e prodhimit dhe në këtë kontest edhe në rritjen e vlerës së eksporteve.

Tab3: Top 5 nën-sektorët kryesorë të sektorit të industrisë së ushqimit dhe pijeve (mil €)

Produkti/Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	2,337	2,159	2,578	4,049	5,567	6,978	7,355	8,253	9,153	11,331	12,933
Birrë	486	527	660	1,012	1,475	1,597	1,736	2,593	4,089	7,849	9,030
Verë prej rrushit të freskët	2,789	1,753	1,860	2,280	2,649	4,015	2,912	4,209	2,956	3,397	4,694
Çokolatë dhe produktet e tjera që përmbajnë kakao	1,143	1,132	1,808	289	1,386	1,800	2,660	2,818	2,397	1,909	1,761
Zarzatet, frutat, arrat dhe pjesë të tjera të bimëve, të përg në uthull	300	136	250	278	405	418	444	580	1,632	2,589	1,468


Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig8: Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar - Eksporti (mil €)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig9: Birrë - Eksporti (në 000,€)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig10. Verë prej rrushit të freskët - Eksporti (mil €)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig11. Çokolatë dhe produktet e tjera që përmbajnë kakao - Eksporti (në 000,€)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig12. Zarzavatet, frutat, arrat dhe pjesë të tjera të bimëve, të përg në uthull- Eksporti (në 000,€)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig13. Reçelet, marmelatat - Eksporti (në 000,€)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit


Fig 14. Torte, kek, biskotat dhe produkte të tjera të furrtarit - Eksporti (në 000,€)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Po ashtu produktet bimore janë përbërës tjerë të rëndësishëm në strukturën eksportive, ndonëse me një peshe më të vogël por që renditen si kategori e grup mallrash me ndikim të veçantë për eksportet kosovare. Produktet e klasifikuara si produkte bimore kanë përfaqësuar 4.8 % të eksporteve të përgjithshme të Kosovës në vitin 2015, (5.4% në 2016), (6.3% në 2017) dhe (6.5% në 2018).

Fig15. Produktet bimore - Eksporti (mil €)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Produkti/Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Fruta të tjera, të freskëta (Luleshtrydhe, Manaferra të buta (Raspberries)etj	601	126	511	1,467	1,315	1,574	1,838	1,917	2,721	4,695	4,677
Fruta dhe arra, të pa gatuar apo të gatuar në avull ose të zier në ujë	42	60	6	91	87	259	531	667	748	3,442	3,157
Kafe, e pjekur, e pa dekafeinizuar	559	589	330	268	479	828	1,949	2,629	1,903	2,998	3,053
Miell gruri dhe miell meslini	2,735	3,495	6,174	7,224	8,299	8,421	6,500	4,165	4,136	4,228	2,392
Bimët dhe pjesë të bimëve (përfshirë farat dhe frutat)	212	28	430	422	604	683	1,256	1,171	1,185	1,412	2,150

Tab4: Top 5 nën-produktet kryesorë të sektorit të produkteve bimore - Eksporti (në 000, €)


Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig16. Fruta të freskëta luleshtrydhe, manaferra - Eksporti (000,€)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig 17. Fruta dhe arra, të pa gatuar apo të gatuar në avull ose të zier në ujë - Eksporti (në 000,€)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig18. Miell gruri dhe miell meslini - Eksporti (mil €)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig19. Bimët dhe pjesë të bimëve (përfshirë farat dhe frutat) - Eksporti (mil €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

Fig20. Kërpudha të freskëta dhe të përgatitura - Eksporti (000,€)



≈ Sektorë tjerë jo me pake rëndësi për ekonomin e vendit konsiderohet te jete: Sektori i plastikës, tekstilit, lëkurës, drurit dhe veshmbathjeve, përfaqësojnë një përqindje prej 18% të eksporteve të Kosovës ne 2016, ne 20% ne 2018 me tendence rritje nga viti ne vit, për me shumë shih tabelën dhe grafikët e mëposhtëm.


Seksionet sipas (HS)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	6,476	6,357	8,153	12,429	14,003	18,205	16,268	23,470	28,872	35,630	44,796
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	4,861	4,454	9,683	9,406	10,418	11,691	11,365	10,769	11,192	11,826	10,933
Druri dhe artikuj druri	1,730	876	1,271	1,627	1,817	2,134	2,720	2,463	3,631	4,407	5,664
Tekstil dhe artikuj tekstili	2,536	5,241	8,328	11,697	11,433	12,751	14,691	11,957	8,785	9,940	10,643
Veshmbathje të këmbëve	102	95	51	86	154	651	1,777	3,031	3,372	2,729	2,064

Tab5: Eksporti i plastikës, tekstilit, lëkurës, drurit dhe veshmbathjeve, (000, €)

Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- **Plastikë, gome dhe artikuj prej tyre** – Kategori tjetër e rëndësishëm në strukturën e eksporteve janë produktet që i perkasin sektorit të plastikës, reflekton një rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Ky sektor ka mbuluar 3% të eksporteve të përgjithshme në (2006), 7.2% në 2015, 9.3% (2016) dhe së fundi 12% në (2018) ose e shprehur në vlerë nga 6.4 milion sa ka qenë në vitin 2008 në 44.7 milion euro në 2018.


Fig21: Plastik, gomë dhe artikuj prej tyre – Eksporti (mil €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- Tekstili dhe artikuj tekstili** - Analizat statistikore për tregtinë e jashtme referuar sektorit të tekstit tregon se ky sektorë përfaqësojnë 3.7 për qind të eksporteve në nivelin e përgjithshëm të eksporteve (2015) dhe 2.8% (2016), ulje të vlerës prej 26% në raport me vitin paraprak, por nga 2016 përsëri kemi një rritje të vlerës eksportuese, kështu në vitin 2018 eksportet janë rritur për 7% krahasuar me një vitin paraprak. Ndonëse me ndikime me të vogël në nivelin eksportesh të përgjithshme, perspektiva e rritjes së prodhimit në sektorin e Tekstit dhe artikujve tekstili është optimiste për më shumë shih Fig.nr 22.


Fig22. Tekstil dhe artikuj tekstili - Eksporti (000, €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- Lëkurë dhe artikuj prej tyre**

Fig23. Lëkur dhe artikujt prej lëkure - Eksporti (mil €)




Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- Druri dhe artikujt prej druri**

Karakteristikë e sektorit të drurit është se ky sektorë konsiderohet të jetë një nga sektorët strategjik të industrisë së Kosovës me potencial të madh për të zhvilluar. Gjatë analizimit të statistikave zyrtare kuptuam se vlera e mallrave të eksportuar nga ky sektorë është duke u rritur e veçmas gjatë vitit 2016 ku është shënuar një rritje eksporteve për 47% krahasuar me vitin 2015. Shifrat e analizuar edhe për vitin 2017, 2018 tregojnë qartë se nuk kemi arsye për të mos besuar se perspektiva e sektorit

perceptohet të jetë mjaft pozitive. Vetëm nga krahasimi i eksportit në 2018 në raport me atë të vitit 2014 shohim se kemi një rritje prej mbi 100%.


Fig24. Druri dhe artikujt prej druri – Eksporti (000, €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit

- **Veshmbathje të këmbëve**

Fig25. Veshmbathje të këmbëve - Eksporti (000, €)



Burimi: ASK, kalkuluar nga autorja e raportit